Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

DREJTORIA PËR PUNËT INSPETUESE
UPRAVA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPEKTION

Raporti i punës tremujore i Drejtorisë për punët inspektuese

Për periudhën janar-maj 2011, Drejtoria për punët inspektuese, ka planifikuar të realizojë detyrat e punës, sipas planit të punës për periudhën janar-dhjetor 2011, që burojnë nga ligjet, rregulloret dhe udhëzimet që janë në fuqi.

Qëllim madhor i këtij planifikimi është mbrojtja sa më efikase e interesave të qytetarëve të komunës së Rahovecit, në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit si: institucionet shtetërore, organet komunale, komuniteti i biznesit, qytetarët.

Ndër detyrat e para që kemi realizuara ka qenë përpilimi i planit të punës për periudhën njëmujore,ëtremujore, gjashtëmujore dhe njëvjeçare, pastaj është bërë riorganizimi i grupeve punuese, është përpiluar një rregullore e brendshme e punës, që është në zbatim.

Ndër punët konkrete që i ka kryer drejtoria për periudhën tremujore janë:

- Regjistrimi i bizneseve në terren , me ç'rast janë vizituar 1004 biznese, prej tyre janë evidentuara 729 me leje pune, 136 pa leje pune, 21 janë në procedurë. Disa janë janë evidentuar si pasive.

Vlen të ceket se evidentimi i bizneseve është bërë edhe në lagjen serbe të Rahovecit si dhe në Hoçë të Madhe. Momentalisht janë duke u kryer procedurat e regjistrimit nga një numër i tyre, ndërsa për të tjerat që nuk kanë bërë kërkesë janë duke u marrë masat që parashihen me ligj.

- Në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve publike është përgatitur një memorandum mirëkuptimi me subjektet e ndryshme që shfrytëzojnë hapësirat publike dhe ky dokument ju është dërguar të gjitha këtyre subjekteve si dhe është përgatitur raporti.

- Janë vizituar të gjitha objektet e QMF-ve dhe QKMF-së, me qëllim regjistrimin e gjendjes në kuptimin e pastërtisë si dhe respektimin e normatives ligjore, siç janë lista esenciale e barnave dhe respektimi i orarit të punës në objektet përkatëse.

- Janë vizituar të gjitha shkollat për të regjistruar gjendjen infrastrukturore. Është përgatitur raporti për shfrytëzimin e sipërfaqes publike, ekspozimin e mallit dhe vendosjen e karrigeve në këto sipërfaqe.

- Është përgatitur raporti për gjendjen e lumit Drini i Bardhë, si dhe janë siguruar foto që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese të këtij lumi

- Është punuar në përgatitjen e propozimeve të reja për taksa dhe tarifa për Rregulloren e re të komunës sonë

- U janë dhënë detyra shtesë inspektorëve për evidentimin e subjekteve të reja afariste.

- Është përgatitur raporti për pikat e zeza (deponive ilegale si dhe daljet e ujërave të zeza në lumenj).

Në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve publike dhe departamentin për mbrojtjen e mjedisit, këtë muaj e kemi shpall; muaji i pastrimit dhe mbrojtjes së mjedisit. Janë marrë masa konkrete në këtë drejtim.

- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kemi pasur disa aksione të përbashkëta.

- ❖ Me Ministrinë e tregtisë, gjegjësisht me inspektorët e kësaj ministrie po ashtu kemi pas disa aksione, siç janë inspektimi nëpër lokale të ndryshme hoteliere lidhur me respektimin e ligjit anti duhan.
- ❖ Janë vizituar të gjitha pikat e karburanteve lidhur me kontrollimin e licencave dhe afatin e tyre, si dhe janë vërtetuar nëse janë të kalibruara.

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, drejtoria jonë ka arritur rezultate të pa krahasueshme si në numrin e vizitave të inspektoreve tanë, ashtu edhe në të hyrat që i janë sjelle komunës përmes inspetoriatit. Gjatë periudhës janar dhjetor 2010 janë dhanë 96 leje pune, ndërsa në këtë vit për tre muaj janë dhënë 72 leje pune, të shndërruar në vlerë monetare për 2010 janë inkasuar gjithsej 5490.00 €, ndërsa për periudhën tremujore janë inkasuar 3720 eu. Po ashtu për këtë periudhë tremujore kanë qenë të planifikuara 1350 vizita në terren, ndërsa janë kryer 1872 vizita. Këto të dhëna që i paraqitem në këtë raport nuk na japim komoditet, por përkundrazi janë një shtytje që edhe më tutje të vazhdojmë me punë në mbrojtjen e popullatës, si dhe në zvogëlimin e ekonomisë informale në komunën tonë.

Drejtori
Shemsi Ibrahimi

shemsi_ibrahimi@hotmail.com